

Toku u paguar

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBETARE E NOTEREVE
DEGA VENDORE TIRANE
NOTERE PUBLIKE ERMIRA B. KAPLLANI



ADRESA: Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla II, Kati I, Tiranë.

Mob. 00355 (0) 69 60 42 358;

e-mail: ermirakapllani@hotmail.com

Nr. 2925 Rep.

Nr. 737 Kol.

KONTRATË SHITBLERJE KUOTE

Në Tiranë, sot, në datën 29/12/2020 (dymije e njëzetë), përpara meje noteres publike, Ermira B. Kapllani, Anetare e Degës Vendore të Noterisë Tiranë, me adresë në Bulevardin "Gjergj Fishta", Tiranë, u paraqitën personalisht palët:

PALA SHITËSE:

1. Migen Kasaj, me cilësinë e njërit prej ortakëve të shoqërisë "Security Solution & Distribution" sh.p.k me nr. NUIS L42227006B, i cili zotëron aktualisht 1 (një) kuotë me vlere nominale 5.000.000,00 lekë (pesë milionë lekë) dhe përfaqëson 50% të kapitalit themeltar, atësia Luan, amësia Elida, shtetas shqiptar, lindur në Sarandë dhe banues në Tiranë, me adresën në rrugën Irfan Tomini, Njësia Administrative Nr. 7, Njësia bashkiake nr. 7, Tiranë, lindur më 07.05.1980, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID me nr. personal I00507210A.

PALA BLERËSE:

Shoqëria R&M GROUP sh.p.k., regjistruar si person juridik në QKB me NUIS M01815004H, me seli në adresën "Njësia Bashkiake nr. 7, Rruga e Kavajës, Pallatet "Park Construction Albania", Godina D, Hyrja A, Kati 1, përfaqësuar nga Administratori Laert Kasaj (i cili është dhe ortak i vetëm i shoqërisë), atësia Luan, amësia Elida, shtetas Shqiptar, lindur në Skrapar dhe banues në Tiranë, me adresë në rrugën "Medar Shtylla", Nd. 32/1, H. 1, Njësia Administrative Nr. 5, Njësia Bashkiake Nr. 5, Tiranë, lindur më 06.03.1985, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim (ID) me nr. personal I50306150V, (në vijim, *blerësi*).

MEQËNËSE EKZISTOJNË FAKTET:

- Shitësi, si më sipër, është një prej ortakëve të shoqërisë "SSD" shpk, e regjistruar në QKB, më datë 27.10.2014, pajisur me nr. NIPTI L42227006B, me adresë "Njësia Bashkiake Nr. 7, Rruga e Kavajës, Pallatet e Shoqërisë "Park construction albania", Kati 1, Dyqan, Tiranë, Shqipëri., me administrator z. Emiljano Fetahu, lindur më 18.06.1979, në Tiranë dhe banues në Tiranë, me gjendje i martuar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Letërnjoftim ID, me nr. personal H90618156T.
- Ortaku i shoqërisë "SSD" Shpk, me vendimin nr. 03, datë 23.12.2020, ka rënë dakord për shitjen e kuotës së tij si një nga ortakët e shoqërisë "SSD" shpk, palës blerëse R&M GROUP shpk.
- Shoqëria R&M GROUP SH.P.K dëshiron dhe blen kuotën përkatëse të shitësit si më sipër, duke u bërë pronar i 1 (një) kuote me vlerë 5.000.000,00 (pesë milionë) lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SSD" shpk, bazuar në vendimin e shoqërisë nr. 05, datë 23.12.2020.

Palët e mësipërme, me vullnet të lirë dhe të plotë, kërkuan hartimin e kësaj kontrate shitje kuote, me përmbajtjen si më poshtë:

Te dhenat personale mbrohen me ligj



1. LIGJI I ZBATUESHËM

- 1.1 Hartimi dhe nënshkrimi i kësaj kontrate bazohet në nenet 705 e vijues të Ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", në Ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në Ligjin nr. 110/2018, "Për Noterinë" dhe në Ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
- 1.2 Kjo është një kontratë me detyrime të dyanshme dhe palët detyrohen reciprokisht ndaj njëra-tjetrës. Ato shprehin vullnetin që të përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi dhe, në këtë rast, detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë marrin fuqinë e ligjit për palët.
- 1.3 Kjo kontratë rregullohet dhe interpretohet nga ligji shqiptar. Për të gjitha çështjet që nuk rregullohen shprehimisht nga kontrata, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe ligjeve të tjera të zbatueshme.

2. INTERPRETIMI I KONTRATËS

- 2.1 Kjo kontratë do të interpretohet duke mbajtur parasysh që qëllimin e palëve siç është shprehur në këtë kontratë.
- 2.2 Secili nga kushtet e kësaj kontrate interpretohet në mënyrën që mundëson realizimin e objektit të saj.
- 2.3 Titujt e neneve të kësaj marrëveshjeje nuk ndikojnë në interpretimin e tyre.
- 2.4 Në këtë marrëveshje:
- 2.4.1 Njëjësi përfshin shumësin dhe anasjelltas, me përjashtim të rastit kur nga konteksti del plotësisht e qartë që zbatohet vetëm njëjësi ose shumësi, sipas rastit.
- 2.4.2 Afatet në ditë interpretohen si afate në ditë kalendarike. Dita, në të cilën ndodh ngjarja që shkakton fillimin e afatit, nuk llogaritet në afat.
- 2.5 Fjalët e përdorura në këtë marrëveshje kanë, sipas radhës, këtë kuptim:
- 2.5.1 Kuptimin e dhënë nga përkufizimet e kësaj marrëveshjeje.
- 2.5.2 Kuptimin e dhënë nga ligji dhe praktika gjyqësore.
- 2.5.3 Kuptimin e tyre të përgjithshëm si fjalë shqipe.

3. QËLLIMI I KONTRATËS

- 3.1 Blerësi ka si qëllim që, me shpenzimet e veta, të blejë kuotën e ortakut të shoqërisë "Security Solution & Distribution sh.p.k dhe të bëhet një nga 2 (dy) ortakët e kësaj shoqërie.
- 3.2 Shitësi ka si qëllim të shesi kuotën e tij si pronar dhe ortak në shoqërinë "SSD" sh.p.k duke humbur çdo të drejtë të tij si ortak mbi këtë kompani.
- 3.3 Kjo kontratë ka si qëllim që palët të krijojnë një marrëveshje të plotë dhe të vetme që do të jetë në fuqi nga momenti i nënshkrimit deri në momentin e regjistrimit të saj në regjistrat tregtare.
- 3.4 Kjo kontratë jep garanci dhe mbron palët në mënyrë të barabartë, duke i dhënë mundësi blerësit të procedojë me regjistrimin menjëherë pas nënshkrimit të saj.

Te dhenat personale mbrohen me ligj



4. OBJEKTI I KONTRATËS

4.1 Objekti i kësaj kontrate është: shitja e kuotës së Migen Kasaja, në shoqërinë "SSD" shpk, si më poshtë:

4.1.1 Migen Kasaj, zotërues i 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 5.000.000,00 (pesë milionë) lekë, që përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SSD" shpk ia shet shoqërisë "R&M GROUP" shpk, në çmimin 100.000,00 (njëqind mijë) lekë.

4.2 Blerësi "R&M GROUP" shpk, me NUIS M01815004H, blen si më poshtë:

4.2.1 Shoqëria R&M GROUP" shpk, blen 1 (një) kuotë që përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SSD" shpk, nga ortaku Migen Kasaj, në çmimin **100.000,00 (njëqind mijë) lekë, duke u bërë ortak dhe pronar, i një kuotë me vlerë nominale 5.000.000,00 (pesë milionë) lekë dhe që përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SSD" sh.p.k me NUIS L42227006B me seli në adresën Njësia Bashkiake Nr. 7, Rruga e Kavajës, Pallatet e Shoqërisë "Park Construction Albania", Kati 1, Dyqan, Tiranë ,Shqipëri,**

4.2.2 Shitësi, nëpërmjet kësaj kontrate deklaron se me vullnet të lirë dhe të plotë si dhe në bazë të legjislacionit në fuqi dëshiron që të transferoj nëpërmjet shitjes, kuotën e zotëruar në shoqërinë "SSD" shpk, në favor të blerësit, shoqërisë "R&M GROUP" sh.p.k, i cili deklaron se është plotësisht dakort që të blejë kuotën që shitet si më sipërpërcaktuar, dhe blerësi bëhet pronar 1 (një) kuote që përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SSD" shpk, me NUIS L42227006B.

5. ÇMIMI I SHITJES

5.1 Palët në marrëveshje të përbashkët kanë rënë dakort se çmimi i shitblerjes së kuotës që po transferohet nëpërmjet kësaj kontratë shitje është **100.000,00 (njëqind mijë) Lekë.**

5.2 Me nënshkrimin e kësaj kontratë, shitësi deklaron se nuk ka asnjë pretendim financiar midis tij dhe blerësit dhe deklaron se janë likuiduar midis tyre, jashtë kësaj Zyre Noteriale, para nënshkrimit të kësaj kontratë, dhe se nuk ka dhe nuk do të ketë asnjë pretendim kundrejt palës blerëse, sot, apo në të ardhmen.

5.3 Shoqëria R&M GROUP sh.p.k deklaron në përgjegjësinë e tij personale dhe ligjore se është likuiduar para nënshkrimit të kësaj kontratë, jashtë kësaj zyre noteriale dhe nuk ka asnjë pretendim financiar kundrejt palës shitëse, sot, apo në të ardhmen.

NENI 6 PËRGJEGJËSITË DHE GARANCI TË PALËVE

6.1 Shitësi, nëpërmjet kësaj kontrate, garanton, si më poshtë:

- a) se është i vetmi titullar i ligjshëm i kuotës që po transferon me këtë kontrate shitje;
- b) se kuota objekt shitje është plotësisht e lirë nga cdo barrë, detyrim, të drejta reale apo cdo lloj kufizimi tjetër.
- c) Se shoqëria nuk ka detyrime financiare te pashlyera apo aq më tepër të padeklaruara ndaj institucioneve shtetërore apo personave të tretë fizik apo juridik;
- d) Kjo Kontrate nënshkruhet dhe dorëzohet rregullisht nga Shitësi dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv për Shitësin dhe që duhet zbatuar prej tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e Kontratës;

Te dhenat personale mbrohen me ligj



- e) Mbi blerësin nuk rëndon asnjë detyrim i lindur mbi kuotën që zotëron deri në momentin e kalimit të pronësisë të saj;
- f) Shitësi heq dorë nga çdo pretendim në lidhje me fitimin që përfiton në formën e dividendit ose çdo përfitim tjetër deri në datën e transferimit të kuotës me vlerë të përgjithshme 5.000.000,00 Lekë, që përfaqëson 50% të kapitalit, të shitur nëpërmjet kësaj kontrate, duke filluar nga data e sotme.

7. KALIMI I TË DREJTËS SË PRONËSISË

7.1 Ortaku i shoqërisë "SSD" sh.p.k deklaron nën përgjegjësinë e tij personale se me nënshkrimin e kësaj kontrate heq dorë nga të gjitha të drejtat që i takojnë kuotës përkatëse që po transferohet nëpërmjet kësaj kontrate dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet lidhur me kuotën objekt i kësaj kontrate shitje, i kalojnë blerësit shoqërisë R&M GROUP shpk, me NUIS M01815004H, dhe i cili bëhet pronar-ortak i një kuote me vlerë nominale 5.000.000,00 lekë dhe përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SSD" shpk me NUIS L42227006B, me seli në adresën "Njesia Bashkiake Nr. 7, Rruga e Kavajës, Pallatet e Shoqërisë "PARK CONSTRUCTION ALBANIA ", Kati 1, Dyqan, Tiranë ,Shqipëri,

8. PASOJAT E KALIMIT TË KUOTAVE

8.1 Pas nënshkrimit të kësaj kontrate shoqëria "SSD" sh.p.k me NUIS L42227006B do të ketë 2 ortak si më poshtë:

1. Shoqëria "**R&M GROUP**" sh.p.k me nr.NUIS M01815004H, ortak dhe pronar, i një kuotë me vlerë nominale 5.000.000,00 (pesë milionë) lekë dhe që përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SSD" sh.p.k me NUIS L42227006B me seli në adresën Njesia Bashkiake Nr. 7, Rruga e Kavajës,Pallatet e Shoqërisë "Park Construction Albania", Kati 1, Dyqan, Tiranë ,Shqipëri,
2. **Emiljano Fetahu**, lindur më 18.06.1979, në Tiranë dhe banues në Tiranë, me gjendje i martuar, madhor,me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me Letërnjoftim ID, me nr.personal H90618156T, ortak dhe pronar, i një kuotë me vlerë nominale 5.000.000,00 (pesë milionë) lekë dhe që përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SSD" sh.p.k me NUIS L42227006B me seli në adresën Njesia Bashkiake Nr. 7, Rruga e Kavajës,Pallatet e Shoqërisë "Park Construction Albania", Kati 1, Dyqan, Tiranë ,Shqipëri.

8.2 Personi që kalon kuotën dhe ai që i fiton ato, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga çasti i kalimit të kuotës dhe deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas dispozitave në fuqi.

NENI 9 INFORMACIONI KONFIDENCIAL

9.1 Palët detyrohen të mbajnë konfidencial të gjithë dokumentacionin, të dhënat dhe cdo informacion të përfituar gjatë marrëdhënies së tyre në shoqëri apo dhe referuar marrëdhënies konkrete të krijuar me këtë kontratë.

NENI 10 TRANSFERIMI I TË DREJTAVE

Te dhenat personale mbrohen me ligj



- 10.1 Menjëherë pas nënshkrimit të palëve, kontrata do të depozitohet dhe regjistrohet nga palët bashkarisht dhe /apo secila prej tyre veç e veç, pranë regjistrarit tregtar në QKB.
- 10.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate, shitësi zhvishet nga çdo e drejtë që buron nga titulli i pronësisë mbi kuotën në shoqërinë "SSD" shpk, kuotë e cila i shitet me këtë kontratë blerësit dhe një nga ortakët e shoqërisë "SSD" sh.p.k, me NUIS L42227006B, me të drejta të plota, bëhet shoqëria R&M GROUP SHPK, që përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë SSD shpk.

NENI 11 LIGJI I APLIKUESHEM DHE GJYKATA KOMPETENTE


- 11.1 Kontrata është hartuar në përputhje me Legjislacionin tregtar në fuqi.
- 11.2 Palët angazhohen të bëjnë çdo përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve të mundshme që mund të krijohen midis tyre, lidhur me këtë kontratë nëpërmjet negocimeve të drejtëpërdrejta.
- 11.3 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo konflikteve midis tyre, çështja do të nënshtrohet juridiksionit gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

12. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

- 12.1 Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga të dyja palët.
- 12.2 Palët respektojnë konfidencialitetin e informacioneve që lidhen me palën tjetër.
- 12.3 Palët mund ta përdorin informacionin konfidencial të palës tjetër vetëm për qëllimet e kësaj kontrate dhe mund t'ua japin këtë informacion punonjësve të tyre, drejtorëve, nënkontraktorëve, agjentëve, furnizuesve, këshilltarëve profesionalë dhe shoqërive të lidhura vetëm në masën që është e nevojshme për arritjen e qëllimit të kësaj kontrate.
- 12.4 Përpunimi i të dhënave personale të mbledhura në zbatim të kësaj kontrate (sipas ligjit nr. 9887, 10.3.2008) bëhet vetëm për qëllim të administrimit të marrëdhënies që lind nga kjo kontratë. Të dhënat përpunohen nga pala që i zotëron dhe nuk u shpërndahen të tretëve.
- 12.5 Secila palë ka në çdo kohë të drejtë t'i kërkojë palës tjetër ndryshimin ose fshirjen e të dhënave të tij apo të kundërshtojë përdorimin e tyre për dërgimin e informacioneve dhe materialeve tregtare që nuk lidhen me këtë kontratë. Kjo e drejtë ushtrohet nëpërmjet komunikimit me shkrim.
- 12.6 Palët deklarojnë dhe konfirmojnë që kjo kontratë është lidhur me vullnetin e tyre të lirë dhe se ata janë në dijeni të pasojave ligjore që rrjedhin nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate.
- 12.7 Dokumentat që janë pjesë e kësaj kontrate janë:
- 12.7.1 Ekstrakt i Regjistrarit Tregtar për Shoqërinë "SSD" shpk me nr.NUIS L42227006B ;
- 12.7.2 Ekstrakt i Regjistrarit Tregtar për Shoqërinë R&M GROUP shpk, me NUIS M01815004H";
- 12.7.3 Vendim i asamblesë së ortakëve të shoqërisë "SSD" shpk, nr.03, datë 23.12.2020;
- 12.7.4 Vendim i asamblesë së ortakëve të shoqërisë "R&M Group" sh.p.k, me nr.05, datë 23.12.2020;
- 12.7.4 Vërtetim i Regjistrarit të Barrëve Siguruese.
- 12.7.5 Dokumentet e identifikimit të palëve;
- 12.8 Kjo kontratë përpilohet në 3(tre) kopje origjinale, me të njëjtën vlerë.

- Kjo kontratë është hartuar në 3(tre) kopje, në gjuhën Shqip, me vlerë të njëjtë ligjore nga një për secilën palë, të cilat e lexuan, kuptuan dhe meqënëse kontrata është hartuar në përputhje me vullnetin e tyre dhe ligjin, e nënshkruajnë personalisht dhe pa vërejtje përpara meje noterit.

Te dhenat personale mbrohen me ligj



- Pas nënshkrimit të palëve, unë noterja e nënshkrova dhe e vërtetova kontratën sipas kërkesave të ligjit "Ligjin nr. 110/2018, "Për Noterinë".

PALËT KONTRAKTORE

SHITËSI

Migen KASAJ

Migen Kasaj



BLERËSI
R&M GROUP SH.P.K
LAERT KASAJ



NOTERE

ERMIRA B. KAPLLANI

Ermira B. Kapllani



**VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË TREGTARE
SECURITY SOLUTION & DISTRIBUTION SH.P.K
(Nr 03 datë 23 / 12 /2020)**

Sot, më date 23.12.2020, në selinë e shoqërisë Security Solution & Distribution sh.p.k, me nr.NUIS L42227006B, me adresë në "Njesia Bashkiake Nr. 7, Rruga e Kavajes, Pallatet e Shoqerise "Park Construction Albania", Kati 1, Dyqan, Tiranë ,Shqipëri, u mbledh asambleja me ortakët e shoqërisë me të dhëna si më poshtë:

1. **Migen KASAJ**, shtetas Shqiptar, lindur më 6 Mars 1985, në Skrapar, banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit nr.033676531, me nr. personal I50306150V, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar.
2. **Emiljano FETAHU**, shtetas Shqiptar lindur më 18 Qershor 1979, në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit nr.034052639 , me nr.H90618156T, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për te vepruar.

Gjatë kësaj mbledhjeje u mor në shqyrtim ky rend dite:

1. Shitjen e kuotës të njërit prej ortakëve ,Z.Migen Kasaj, si më poshtë vijon:
 - 2.1 Shitjen e kuotës të ortakut të shoqërisë SSD shpk, z.Migen Kasaj, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SSD" shpk, shoqërisë "R&M GROUP" shpk, me nr.NUIS M01815004H, regjistruar në regjistrin tregtar më datë 15.06.2020, me seli në Tiranë, në Rrugën e Kavajës, Park Construction Albania (Kompleksi Delijorgji), Godina D, Hyrja A, Kati 1, përfaqësuar nga administratori z.Laert Kasaj, mbajtës i letërnjoftimit elektronik nr. 033676531, me nr. Personal I50306150V, në çmimin total 100.000,00 (njëqind mijë lekë). Shoqëria R&M GROUP shpk bëhet pronar dhe ortak i një kuotë me vlerë nominale 5.000.000,00 (pesë milionë) lekë dhe përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SSD" sh.p.k me NUIS L42227006B.
 2. Ngarkohet administratori i shoqërisë për zbatimin e këtij Vendimi dhe regjistrimin në QKB. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
 3. Të tjera.

Në përfundim, ortaku i vetëm i shoqërisë pasi u njoh me rendin e ditës dhe pasi shqyrtoi materialin e paraqitur, në zbatim të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe Statutit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shitjes së kuotës të njërit prej ortakëve, Z.Migen Kasaj, si më poshtë vijon:
 - 2.2 Shitjen e kuotës së ortakut të shoqërisë Security Solution & Distribution shpk, z.Migen Kasaj, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SSD" shpk, palës blerëse, shoqërisë "R&M

Shoqëria : Security Solution & Distribution (SSD)

Nipt : L42227006B

Adresa : Tiranë, Rruga e Kavajës, Njësia Bashkiake Nr.7, Pll e Shoqërisë "PARK CONSTRUCTION ALBANIA" sh.p.k,

GROUP" sh.p.k, me nr.NUIS M01815004H, regjistruar në regjistrin tregtar më datë 15.06.2020, me seli në Tiranë, në Rrugën e Kavajës, pallatet e shoqërisë "Park Construction Albania" (Kompleksi Delijorgji), Godina D, Hyrja A, Kati 1, përfaqësuar nga administratori z.Laert Kasaj, mbajtës i letërnjoftimit elektronik nr.033676531, me nr. Personal I50306150V, në çmimin total 100.000,00 (njëqind mijë lekë). Shoqëria R&M GROUP sh.p.k bëhet pronar dhe ortak i një kuotë me vlerë nominale 5.000.000,00 (pesë milionë) lekë dhe përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SSD" sh.p.k me NUIS L42227006B.

2. Ngarkohet administratori i shoqërisë për zbatimin e këtij Vendimi dhe regjistrimin në QKB. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Të tjera.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË SECURITY SOLUTION & DISTRIBUTION SH.P.K

Z. Migen KASAJ

Migen Kasaj

Z. Emiljano FETAHU

Emiljano Fetahu



VENDIM I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË TREGTARE
R&M GROUP SH.P.K

(Nr. 05, datë 23 / 12 /2020)

Në Tiranë, sot, më datë 13. 12.2020, në selinë e shoqërisë "R&M GROUP" sh.p.k., me adresë në "Rruga e Kavajës", pallatet e shoqërisë "Park Construction Albania", Godina D, Hyrja A, Kati I, Tiranë, Shqipëri, sipas lajmërimit të datës 12. 12.2020, u mbledh Asambleja e Ortakut të vetëm të shoqërisë "R&M GROUP" sh.p.k., shoqëri shqiptare, regjistruar në mënyrë të rregullt në Regjistrin Tregtar në datë 15.06.2020, me NUIS M01815004H (referuar më poshtë si shoqëria), përfaqësuar nga ortaku i vetëm i shoqërisë dhe njëkohësisht administratori, si më poshtë:

1.Z.Laert Kasaj, i biri i Luanit, shtetas shqiptar, lindur më 06.03.1985 në Skrapar, banues në Tiranë, Shqipëri, i pajisur me Letërnjoftim me nr.personal I50306150V, zotërues i 100% të kapitalit të shoqërisë,

për të diskutuar dhe vendosur në lidhje me çështjen e rendit të ditës, të propozuar si më poshtë:

1. Blerjen e kuotës të njërit prej ortakëve të shoqërisë "Security Solution & Distribution" sh.p.k, si më poshtë vijon:
2. Blerjen e kuotës së zotëruar nga ortaku, z.Migen Kasaj, me vlerë nominale 5.000.000,00 (pesë milionë lekë), që përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë Security Solution & sh.p.k, në çmimin 100.000,00 (njëqind mijë) lekë, duke u bërë pronar dhe ortak i një kuotë me vlerë nominale 5.000.000,00 (pesë milionë) lekë dhe përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SSD" sh.p.k me NUIS L42227006B, me seli në adresën Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, pallatet e shoqërisë "Park Construction Albania", Kati 1, Dyqan, Tiranë, Shqipëri
3. Autorizimin e administratorit të shoqërisë "R&M GROUP" sh.p.k. z.Laert Kasaj, të nënshkruajë Kontratën e blerjes së kuotës së ortakut të shoqërisë SSD shpk., në vlerën 100.000,00 (njëqind mijë) lekë, sic përcaktohet në pikën 1.
4. Të tjera.

Në përfundim, ortaku i vetëm i shoqërisë, pasi u njoh me rendin e ditës dhe pasi shqyrtoi materialin e paraqitur, në zbatim të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe Statutit,

V E N D O S I :

1. **Blerjen e kuotës të njërit prej ortakëve të shoqërisë SSD shpk, si më poshtë vijon:**
 - 1.1 Blerjen e kuotës së zotëruar nga ortaku i shoqërisë SSD shpk, z.Migen Kasaj, me vlerë nominale 5.000.000,00 (pesë milionë) lekë, që përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë SSD shpk, në çmimin 100.000,00 (njëqind mijë) lekë, **duke u bërë pronar dhe ortak**

i një kuotë me vlerë nominale 5.000.000,00 lekë dhe që përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë "SSD" sh.p.k me NUIS L42227006B, me seli në adresën "Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, pallatet e shoqërisë "Park Construction Albania", Kati 1, Dyqan, Tiranë, Shqipëri.

2. Autorizimin e administratorit të shoqërisë "R&M GROUP" sh.p.k, z.Laert Kasaj, të nënshkruajë kontratën e blerjes së kuotës së ortakut të shoqërisë SSD sh.p.k., në vlerën 100,000.00 lekë, sic përcaktohet në pikën 1.
3. Të tjera.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË "R&M GROUP" SH.P.K
ORTAKU I VETËM

Z. LAERT KASAJ

(emër, mbiemër, firmë, vlerë)



REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-2020122816419346
Data e Rezultatit të Kërkimit: 28.12.2020
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 4:04:19PM
Lloji i Kërkimit: D-400-099-194
Numri i Dokumentit:
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

Eldo Kemanj

MIGEN LUAN KASAJ

